


Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve-ZKA/2019

Nr. i rekomandimit dhe fusha	Rekomandimet	Veprimet e ndermarrura, dhe rezultatet konkrete ne lidhje me zbatimin e rekomandimeve	Statusi i rekomandimeve(e zbatuar, pjesërisht i zbatuar e pazbatuar	Sfidat e hasura ne zbatimin e rekomandimeve
Rekomandime të lidhur me pasqyrat financiare Vjetore: -A1	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që bëhen harmonizimet në mes të regjistrit të aseteve dhe shënimeve kontabël, në mënyrë që pasqyra e pozicionit financiar dhe shënimet shpjeguese, të prezantojnë informacione të plota dhe të sakta sipas kërkesave të standardeve të kontabilitetit.	Do të behet rakordimi i listës së regjistrit të aseteve me shënimet kontabël sipas kontratave finale mbi koston e tyre, ne mënyrë që të identifikohen ato asete të cilat janë llogaritur me TVSH -16 asete dhe të bëhet korrigjimi i tyre konform SNK 16.-ZKF	<u>E pa zbatuar deri ne TM4-2020</u>	
-A2	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, se janë marrë veprime konkrete për korrigjimin e regjistrit të aseteve në librat kontabël, në përputhje me standardet e kontabilitetit.	Është kontaktuar kompania e programit të kontabilitetit në mënyrë që të behet harmonizimi në mes të programit kontabël dhe regjistrit të aseteve sipas SNK16.-KE -ZKF	<u>Ne proces-TM3-2020</u>	
-A3	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që në një periudhë sa më të shkurtër të bëhet inicimi i një procesi të rivlerësimit të aseteve, në mënyrë që prezantimi i vlerës së tyre në vitet e ardhshme të jetë real dhe në përputhje me standardet e kontabilitetit.	Pasi që të behën korrigjimet e nevojshme konform SNK 8 Politikat kontabël, vlerësimet dhe korrigjimet e gabimeve lidhur me asetet fikse do te rishikohet mundësia e financimit te rivlerësimit nëse ka buxhet apo mbështetje financiare nga MEA për financimin e rivlerësimit te aseteve.- BORDI	<u>E pa zbatuar</u>	

K.R.J. "DRINI I BARDHË"
 "PEJË"
 Nr. 246/20
 Data 30.07.2020
 PEJË

 REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE	
DATE PRANIMUAR/DATE RECEIVED: 14.08.2020 DATUM PRILIZEN DOSTAVLJEN: 14.08.2020 DATE RECEIVED SUBMITTED:	
Nr. Org. / Org. No. 05	Shif. Klasif. / Klasif. Code 47
Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No. 1442	Nr. Stranice / Br. Stranica / No. Pages 5

Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve-ZKA/2019

-A4	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, se janë ndërmarrë veprime konkrete për mënjanimin e pengesave dhe funksionalizimin e aseteve jashtë përdorimit dhe të sigurojë trajtimin e duhur kontabël në pasqyra financiare.	Do të bëhet identifikimi i listës së aseteve që janë të zhvlerësuar tërësisht dhe të behën rregullimet e duhura konform SNK 16 Aktivitet materiale afatgjata në mënyre që PF të paraqiten drejt, dhe vetëm të bëhet shpalosja e tyre.-ZKF	<u>Ne proces TM3-2020</u>	
-A5	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që të bëhet një rishikim i shpenzimeve të zhvlerësimit si dhe korigjimin e gabimeve të identifikuar. Gjithashtu, të siguroj aplikimin e zhvlerësimit bazuar në kërkesat e standardeve.	Do të bëhet korigjimi retrospektiv sipas SNK 8Politikat e kontabilitetit, vlerësimet dhe gabimet mbi gjendjen e shpenzimeve të zhvlerësimit nga periudha 2007-2008 e tutje.-ZKF	<u>Ne proces TM3-2020</u>	
-A6	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, trajtimin e llogarive të arkëtueshme të grumbulluara vite me radhë dhe trajtimi i borxheve të këqija të bëhet në harmoni me kërkesat e rregullores për menaxhimin e të arkëtueshmeve.	Trajtimi i llogarive të arkëtueshme do të bëhet konform rregullores së kompanisë për llogaritë e arkëtueshme, dhe programi softuerik për regjistrimin në kontabilitet do të rregullohet që ti përgjigjet vjetërsisë së llogarive të arkëtueshme.KE-ZKF	<u>Ne proces TM3-2020</u>	
-A7	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, se janë marrë veprime korigjuese lidhur me asetet të cilat janë përfituar nga grantet, për të siguruar vlerë të saktë të hyrave të shtyra dhe të hyrave nga grantet.	Rishikimi i listës së përfituar të garantëve ndër vite duke korigjuar këtu edhe të hyrat e shtyra nga garantët dhe po ashtu edhe shpenzimet e zhvlerësimit. Sipas SNK 20 Grantet Qeveritare. -ZKF	<u>E pazbatuar deri ne TM4-2020</u>	
-A8	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, se janë marrë veprimet për të siguruar evidencat e sakta lidhur me obligimet e pagave ndaj punëtorëve si dhe prezantimin e saktë të tyre në pasqyrat financiare.	Do të bëhet një analizë prej fillimit e raportit nga komisioni për evidentimin e obligimit për paga ndaj punëtorëve dhe të gjitha evidencat që lidhen me të punësuarit(kontratata, qarkullimi bankar, kontributet pensionale, obligimet ndaj pagave, dhe listat e pagave duke filluar nga viti 2008). ZKF	<u>Ne proces-TM3-2020</u>	
-A9	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, deklarin e	Kompania siguron që do të	<u>Ne proces-TM3-</u>	

Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve-ZKA/2019

	tatimit mbi të ardhurat personale, kontributet pensionale për të punësuarit si dhe prezantimin e tyre në pasqyrën e pozitës financiare.	rregullohet procesi i deklarimit tatimor konform Legjislacionit tatimor. ZKF	<u>2020</u>	
-A10	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, se janë marrë veprimet korrigjuese që të dhënat kontabël dhe shumat e prezantuara në pasqyrën e pozicionit financiar, të jenë në harmoni me gjendjen e llogarive tatimore në Administratën Tatimore.	Do të merren hapat e nevojshëm për kontrollimin e programit dhe harmonizimin e tij me të dhënat nga Administrata Tatimore.-ZKF	<u>Ne proces -TM3</u>	
-A11	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, një analizë gjithëpërfshirëse të zërit "Rezervat tjera" dhe të siguroj informacionet përkatëse lidhur me zvogëlimin e shumës së këtij zëri, krahasuar me vitin paraprak për të pasur një pamje të drejtë dhe të vërtetë të tyre.	Te kontrollohet gjendja mbi përbërjen e zërit "Rezervat tjera" duke analizuar edhe shkakun e zvogëlimit të këtij zëri dhe të bëhen shpalosjet e duhura. ZKF	<u>Epa zbatuar-TM4-2020</u>	
-A12	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që janë bërë korrigjimet e gabimeve të identifikuara tek rrjedha e parasë dhe pasqyra e ndryshimeve në ekuitet për të siguruar një pamje të drejtë dhe të vërtetë të tyre.	Rishikim dhe monitorim mbi vlerësimin dhe eliminimin e gabimeve dhe korrigjimin e tyre, si dhe të bëhen shpalosjet e nevojshme. ZKF	<u>Ne proces-TM4-2020</u>	
-A13	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që shënimet shpjeguese të përmbajnë parimet bazë që përdoren për hartimin e pasqyrave financiare dhe informacionet mbi përbërjen e zërave të pasqyrave, janë dhënë sipas kërkesave të standardeve të kontabilitetit.	Janë paraqitur pasqyrat financiare vjetore sipas standardeve duke i përfshira edhe shënimet shpjeguese mbi zërat financiar.-ZKF	<u>E zbatuar.</u>	
-A14	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që gabimet materiale të zbuluara e që i përkasin periudhave paraardhëse, të korrigjohen në informacionin krahasues të paraqitura në pasqyrat financiare për periudhat e mëpasshme.	Do të kontrollohet gjendja e pasqyrave financiare duke analizuar dhe krahasuar me periudhat paraprake për të evidentuar gabimet e mundshme. -ZKF	<u>Ne proces-TM4-2020</u>	

Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve--ZKA/2019

<p>Çështja A15.Llogaritë e arkëtueshme tregtar edhe tjera</p>	<p>Bordi drejtoreve të sigurojë, që me rastin e hartimit të PVF-ve zërat financiar të prezantojnë vlerën e saktë. Po ashtu, të siguroj që të bëhet harmonizimi i shënimeve kontabël me llogaritë e klientëve.</p>	<p>Vlerësimi i gjendjes së PVF dhe kontrollimi i dhe harmonizimi i shënimeve nga programi kontabël me llogarite e klientëve.-ZKF</p>	<p><u>Ne proces-TM3-2020</u></p>	
<p>Çështja A.16.Të hyrat</p>	<p>Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që janë marrë veprimet e nevojshme korrigjuese për të hyrat që janë njohur në momentin e nënshkrimit të kontratave, në mënyrë që informacioni i të hyrave dhe llogarive të arkëtueshme të jetë i saktë. Po ashtu, të sigurojë që të hyrat të njihen vetëm atëherë kur konsumatorët marrin shërbimet e ofruara dhe plotësohen kriteret e standardit për njohje të tyre.</p>	<p>Do të merren veprimet e nevojshme për korrigjimin dhe përmirësimin e kontratave dhe harmonizimin e tyre vetëm në momentin kur e kanë marr shërbimin. ZKF</p>	<p><u>Ne proces-TM3-2020</u></p>	
<p>Çështja B1: Mangësi në faturimin e shërbimeve</p>	<p>Bordi i Drejtorëve të sigurojë, se përcaktimi i tarifave të ujitjes për shërbimet që i ofron, të jetë i bazuar në kriteret e qarta për përcaktimin e tyre. Po ashtu, të sigurojë që brenda një afati sa më të shkurtër janë marrë masat e nevojshme përmirësuese për rastet kur çmimet e vendosura në kontrata nuk janë në përputhje me vendimet e BD, si dhe janë marrë veprime konkrete për kontratat e lidhura me operatorët pa u përcaktuar tarifat nga BD.</p>	<p>Është aprovuar nga BD raporti i përcaktimit të çmimeve për ujitje dhe për operatorët ekonomik. Llogaritja e çmimeve është bërë duke u bazuar në principin e rikuperimit të kostos. ZKF</p>	<p><u>E zbatuar</u></p>	
<p>Çështja A17: Moszbatimi i ndëshkimeve në rastet kur konsumatorët paguajnë shërbimet me vonesë</p>	<p>Bordi i Drejtorëve të sigurojë që, të merren masa ndaj klientëve të cilët nuk i përgjigjen kërkesave për pagesë, të dërgoj vërejtjet dhe në rastet kur konsumatorët nuk i përgjigjen vërejtjeve të aplikohen masat ndëshkuese të përcaktuara në kontratë.</p>	<p>Te zbatohet rregullorja mbi të hyrat dhe të merren masa ndëshkuese ndaj klientëve që nuk ju përgjigjen kërkesave të kompanisë në lidhje me pagesat ndaj tyre. KE-ZKF</p>	<p><u>Ne proces-TM3-2020</u></p>	
<p>Çështja A18. Mosharmonizimi i kontratave të</p>	<p>Bordi i Drejtorëve, të sigurojë që burimet njerëzore, i kanë kryer harmonizimet e kontratave të punonjësve sipas kërkesave të rregulloreve për organizim të brendshëm dhe për</p>	<p>Kjo çështjeje është diskutuar në mbledhjen e fundit të BD dt 16.07.2020, posa të bijën KE një vendim se si do të veprohet me</p>	<p><u>Ne proces deri me 31.12.2020</u></p>	

Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve-ZKA/2019

<p>punonjësve me kërkesat e rregulloreve për organizimin e brendshëm dhe për paga</p>	<p>paga, në mënyrë që të eliminojë trajtimin e pa barabartë të punonjësve në pozita dhe përgjegjësi të njëjta.</p>	<p>pagat e punëtorëve që kanë pas ngritje, do të ndryshohet aneksi -I- i rregullores për pagat dhe kompensimet tjera, dhe pastaj do të behet harmonizimi i kontratave. SEKRETARJA-KE</p>		
<p>Çështja A19: Nënvlërësim i shpenzimeve në pasqyrat financiare</p>	<p>Bordi i Drejtorëve, të sigurojë që Zyra e financave i përfshijnë të gjitha shpenzimet e ndodhura gjatë vitit fiskal, në shumat kontabël dhe shumat në pasqyrat financiare, në mënyrë që të eliminohen nënvlerësimet/ mbivlerësimet e rezultatit financiar.</p>	<p>Kontrolli i të gjitha shpenzimeve dhe paraqitja e tyre sipas parimit aktual dhe pohimit të saktësisë dhe klasifikimit të duhur gjatë vitit si dhe të behet harmonizimi i tyre me programin kontabël. Do të kërkohen kartelat e furnitorëve.-ZKF</p>	<p><u>Ne proces-TM4-2020</u></p>	

Datë: 30.07.2020

Kryeshefi Ekzekutiv

i N.P.K.R.U. "Dhoni e Bardhë" SH.A.Pejë

Bedri Haxhijaj

